



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
GJYKATA E SHKALLËS SË PARË  
PËR KRIME TË RËNDA

NR. AKTI 11  
02.07.2012

NR. VENDIMI 11  
29.10.2012

**VENDIM**  
**“Ne emer te Republikes”**

Gjykata e Shkalles se Pare per Krime te Renda Tirane  
ne trup gjykues te perbere prej gjyqtareve:

**Kryesuese** : Iliriana OLLDASHI  
**Anetare** : Flora HAJREDINAJ  
**Anetar** : Bardhyl DHAMA

Asistuar nga sekretari gjyqesor **Besjan Hysi**, sot ne daten **29/10/2012**,  
**ora 13.00 ne Tirane**, mori ne shqyrtim ne seance gjyqesore publike **çeshtjen nr. 11** qe i perket :

**Padites:** Prokuroria prane Gjykates se Shkalles se Pare per Krime te Renda,  
Tirane, perfaqesuar nga prokurori **B. M. .**

**Te paditur:** **1. Shtetasi nen hetim M. Ç. ,** i biri i M. dhe i H. , i dtl.  
xx/xx/xxxx, lindur ne xxxxxxxx dhe banues ne Elbasan Rruga “xxxxxx x  
xxxxx”, **aktualisht i ndodhur ne Institucionin e Ekzekutimit te Vendimeve  
Penale Berat (gjykuar ne mungese).**

**2. Personi Juridik “K.” sh.p.k.,** perfaqesuar nga shtetasi M. Ç. , me adrese  
Rruga “ xxxxxxx xxxxx ”, Vila nr. x. **(gjykuar ne mungese).**

**Objekti:** Konfiskimi i pasurive

**Baza ligjore:** Ligji nr. 10192 date 03/12/2009 **“Per Parandalimin dhe  
Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave  
Parandaluese Kunder Pasurise”**,

**Ne perfundim te shqyrtimit gjyqesor te zhvilluar ne prani te paditesit te perfaqesuar nga prokurori B. M. qe kerkoi: konfiskimin e pasurive te meposhtme:**

- a) Mjetin e markes Mit Subishi, lloji foristrade, tipi Mitsubishi Pajero, me nr. Shasie XXXXXX XXXXXXXXX, me xxxx, ngjyra xxx me targa **XX XXXX X**
- b) Mjetin e markes Benz, lloji autoveture, tipi Benz 190, me nr. Shasie XXXXXXXXXXXXXXXX, me xxxx, ngjyra e xxxx, me targa **XX XXXX X**.
- c) Mjetin e markes CHRYSLER, lloji autoveture, tipi LLC JEPP PK JK5FH 81, me nr. Shasie XXXXXXXXXXXXXXXX, me xxxx, ngjyra xxx me targa **XX XXXX X**.
- d) Llogarine bankare ne Raiffeisen Bank me nr. XXXXXXXX ne emer te Shoqerise “ K. ” sh.p.k., ne shumen **47,112.17** leke.

**2. Per ekzekutimin** e ketij vendimi te ngarkohen Zyrat e Permbarimit te Rretheve **Tirane dhe Vlore, ndersa per Administrimin dhe perdorimin** e pasurive **Z. K. Xh.** , i cili eshte Administrator ne Agjencine per Administrimin e Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara Prane Ministrise se Financave Tirane.

**-ne mungese te te paditurve M. Ç. dhe Shoqerise “ K. ” sh.p.k.,**

**kjo gjykate pasi shqyrtoi kerkimet perfundimtare dhe mbi vleresimin e provave te ketij gjykimi :**

### **V E R E N s e**

Prokuroria per Krime te Renda Tirane ne cilesine e paditesit ka sjelle per gjykim para kesaj gjykate kerkesepadine me objekt konfiskimin e pasurive te te paditurve M. Ç. dhe “ K. ” sh.p.k mbi bazen e ligjit te posaçem **nr. 10192 date 03/12/2009** *“Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimit te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese Kunder Pasurise”*.

Per kete çeshtje fillimisht Prokuroria per Krime te Renda Tirane, ne baze te akteve te percjella nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Berat ka regjistruar procedimin pasuror **nr. 1 date 06/01/2012** ne ngarkim te shtetasit M. Ç. dhe personit juridik “K.” sh.p.k ne zbatim te parashikimeve te ligjit **nr. 10192 date 03/12/2009**.

Aktet e Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Berat bejne fjale per procedimin penal nr. 82 date 28/02/2011 ne ngarkim te te pandehurve M Ç. dhe personit juridik “K.” sh.p.k me ortak te vetem dhe administrator te pandehurin M. Ç. , per veprat penale te “ Mashtrimit ” dhe “ Pastrimit te produkteve te vepres penale ” te parashikuar nga nenet **143/2 dhe 287** te Kodit Penal .

Mbi bazen e dyshimit te arsyeshem te bazuar ne indicje se te pandehurit “K.” sh.p.k dhe M. Ç. kane kryer vepren penale te “ Pastrimit te produkteve te vepres penale ” te parashikuar nga neni **287** i Kodit Penal nga ana e Prokurorise per Krime te Renda ata jane konsideruar subjekte te ligjit te ligjit nr. 10192 date 03/12/2009.

Per kete arsye ka filluar ndaj tyre hetimi pasuror i rregjistruar me **nr. 1, date 06/01/2012**, nga i cili ka rezultuar se te paditurit kane keto pasuri:

- a- Mjetin e markes Mit Subishi, lloji foristrade, tipi Mitsubishi Pajero, me nr. Shasie XXXXXXXX XXXXXXXX, me xxxx, ngjyra xxx me targa **XX XXXX X.**
- b- Mjetin e markes Benz, lloji autoveture, tipi Benz 190, me nr. Shasie XXXXXXXXXXXXXXXX, me xxxx, ngjyra e xxxx, me targa **XX XXXX X.**
- c- Mjetin e markes DAIMLER CHRYSLER, lloji autoveture, tipi 210016 E27CDI Avangarde, me nr. Shasie XXXXXXXXXXXXXXXX, me xxxx, ngjyra xxx me targa **XX XXXX X.**
- d- Mjetin e markes CHRYSLER, lloji autoveture, tipi LLC JEPP PKJK5FH 81, me nr. Shasie XXXXXXXXXXXXXXXX, me xxxx, ngjyra xxx me targa **XX XXXX X.**
- e- Llogarine bankare ne Raiffeisen Bank me nr. XXXXXXXXXXXX ne emer te Shoqerise “ K.” sh.p.k., ne shumen **47,112.17** leke.

Fillimisht eshte bere sekuestrimi i ketyre pasurive me vendimin **nr. 1 date 28/01/2012** te kesaj gjykate, procedure e parashikuar nga dispozitat e ligjit nr. 10192 date 03/12/2009.

**Mbi kerkesen e dates 16/05/2012 te shtetasit V. L. , shoqeruar nga nje kontrate shitje nr. 2984/1772, date 25/10/2012 me te cilen rezulton se ai ka blere nga “K.” sh.p.k automjetin e markes DAIMLER CHRYSLER, lloji autoveture, tipi 210016 E270 CDI Avangarde, me nr. Shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX, me nafte, ngjyra gri me targa **XX XXXX X,** Prokuroria per Krime te Renda i ka kthyer atij kete automjet dhe ka hequr dore nga kerkimi per konfiskimin e tij.**

Pas kalimit te afatit 6 mujor te parashikuar nga neni **12** i ligjit **“Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet**

*Masave Parandaluese Kunder Pasurise*”, prokurori ka kerkuar konfiskimin e pasurive te te paditurve “K.” sh.p.k dhe M. Ç. dhe kalimin e tyre ne favor te shtetit duke pretenduar se nuk provohet ligjshmeria e prejardhjes se pasurive per te cilat kerkohet konfiskimi.

**Kjo gjykate pas shqyrtimit te kerkimeve dhe provave te paraqitura vlereson se ne baze te nenit 24 te ligjit nr. 10192, date 03/12/2009 “ Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese Kunder Pasurise” duhet te konfiskoje pasurite e te paditurit “K.” sh.p.k. mbeshtetur mbi keto argumenta :**

**Se pari:** Plotesohet kushti i parashikuar ne nenin 24/1 pika a e ligjit nr. 10192, date 03/12/2009 pasi ka dyshime te arsyeshme te bazuar ne indicije per kryerjen nga personi juridik “K.” sh.p.k te veprimtarise kriminale te “Pastrimit te produkteve te vepres penale ” te parashikuar nga neni 287 i Kodit Penal .

Keshtu ndaj personit juridik “K.” sh.p.k eshte rregjistruar ne Prokurorine e Rrethit Gjyqesor Berat, procedimi penal nr. 82 date 28/02/2011 per veprat penale te “Mashttrimit ” dhe “ Pastrimit te produkteve te vepres penale ” te parashikuar nga nenet 143/2 dhe 287 te Kodit Penal arsye per te cilat pasuria e tij i nenshtrohet dispozitave te ligjit te posaçem antimafia e parashikuar kjo ne piken d te paragrafit te pare te nenit 3 te tij.

**Se dyti** Ne kete gjykim nuk u provua prejardhja e ligjshme e pasurive te sekuestruara dhe konkretisht:

1. Mjeti i markes Mit Subishi, lloji foristrade, tipi Mitsubishi Pajero, me nr. Shasie XXXXXX XXXXXXXXXXXX, me xxxx, ngjyra xxx me targa **XX XXXXX**
2. Mjeti i markes Benz, lloji autoveture, tipi Benz 190, me nr. Shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX, me xxxx, ngjyra e xxxx, me targa **XX XXXXX**.
3. Mjeti i markes CHRYSLER, lloji autoveture, tipi LLC JEPP PK JK5FH 81, me nr. Shasie XXXXXXXXXXXXXXXX, me xxxx, ngjyra xxx me targa **XX XXXXX**.
4. Llogaria bankare ne Raiffeisen Bank me nr. XXXXXXXX ne emer te Shoqerise “K.” sh.p.k., ne shumen **47,112.17** leke.

Ne emer te te paditurit, personit juridik “ K. ” sh.p.k. nuk u paraqit ne gjykim asnje perfaqesues i tij, qe te provonte se ne kohen kur jane blere automjetet dhe kur eshte hapur llogaria bankare ai te kete kryer ndonje aktivitet te ligjshem fitimprures dhe aq me pak qe blerja e ketyre automjeteve te jete realizuar me te ardhura te ligjshme dhe qe nuk jane produkt i vepres penale te kryer nga personi juridik dhe perfaqesuesi i tij ligjor shtetasi M. Ç. .

Madje sipas shkreses nr. 19158/1, date 25/05/2011 te Drejtorise se

Pergjithshme te Tatimeve shoqeria "K." sh.p.k, paraqitet si mosdeklaruese te ardhurash qe nga muaji **maj i vitit 2008**.

Po ashtu nga hetimet e çeshtjes penale ne ngarkim te te pandehurve "K." sh.p.k, M. Ç. etj ka rezultuar se i pandehuri M. Ç. ne daten 06/02/2008 ka krijuar shoqerine "K." sh.p.k me objekt te aktivitetit te saj botime shtypi, perhapje e lajmit dhe e promocionit, konsulence juridike etj., me seli ne disa qytete te Shqiperise perfshi dhe qytetin e Beratit. I pandehuri M. Ç. ne marrredhenie me te tretet eshte prezantuar si perfaqesuesi ligjor i shoqerise dhe drejtor i pergjithshem i saj. Shtetasi R. B. ka punuar si drejtor rajonal i shoqerise per Beratin dhe shtetasja A. Dh. si zevendesdrejtoe e pergjithshme dhe ekonomiste.

I pandehuri M. Ç. ne marrredhenie me persona te tjere pretendonte, duke genjyer, se shoqeria e tij financiohej nga USAID. Ndersa nga hetimet ne asnje moment nuk eshte konstatuar qe kjo shoqeri tregtare te kete pasur marrredhenie me USAID-in. Kjo genjeshter perdorej me qellim per te rritur besimin dhe vjedhur klientet. Ky shtetas ne menyre te perseritur ne bashkepunim dhe me shtetasit e permendur me siper u ka marre shtetasve te ndryshem ne disa qytetet te Shqiperise sasine prej 100 000 lekesh ose shuma te tjera me te medha, duke u premtuar punesim dhe trajnime ne fushen e gazetarise, apo duke u premtuar sherbime te tjera si asistence juridike, ndermjetesim tek funksionare shteterore, si tek prokurore, gjyqtare, punonjes te presidences, keshilltare, per lirimin e personave te denuar me burgim, duke i genjyer ne kete menyre qe t'i jepnin shumate e te hollave, me qellim pervetesimin e tyre.

Keto perfitime ky shtetas here i ka marre ne menyre te drejperdrejte dhe here nepermjet llogarise se tij bankare ne Raiffeisen Bank. Nje pjese te ketyre perfitimeve te paligjshme i pandehuri M. Ç. i ka depozituar ne llogarine bankare te shoqerise "K." sh.p.k duke i investuar, si para produkte te vepres penale te "Mashtimit ", ne veprimtarite ekonomike dhe financiare te shoqerise. Keto te holla i pandehuri i ka reklamuar si fitime te ligjshme te realizuara nga veprimtaria e shoqerise "K." sh.p.k.

Ne kete kuader ai ka paguar punonjesit e shoqerise, ka likujduar detyrime ndaj personave te trete si dhe ka blere kater automjetet ne emer te shoqerise dhe pjesen me te madhe e ka terhequr personalisht nga banka. Keto veprime jane kryer me shume se nje here duke sjelle si pasoje pastrimin e nje shume prej me teper se 10 000 000 lekesh.

**Se treti:** Pasurite per te cilat kerkohet konfiskimi jane te gjitha ne emer te te paditurit "K." sh.p.k dhe konkretisht:

- a. Me aktin "Kontrate shitje automjeti" nr. 347/166, date 19/02/2010 provohet

fakti i fitimit te pronesis nepermjet berjes nga ana e te paditurit “Komunitete” sh.p.k, nepermjet perfaqesueses se tij, te nje automjeti te markes Benz, lloji autoveture, tipi Benz 190, me nr. Shasie XXXXXXXXXXXXXXXX, me xxxx, ngjyra e xxxx, me targa **XX XXXX X**.

- b. Me aktin “Kontrate shitje automjeti” nr. 848/432, date 18/03/2010 provohet fakti i fitimit te pronesis nepermjet blerjes nga ana e te paditurit “K.” sh.p.k, nepermjet perfaqesueses se tij, te nje automjeti te markes Mit Subishi, lloji foristrade, tipi Mitsubishi Pajero, me nr. Shasie XXXXXXXXXXXXXXXX, me xxxx, ngjyra xxx me targa **XX XXXX X**.
- c. Me aktin “Kontrate shitje automjeti” nr. 1160/557, date 12/04/2010 provohet fakti i fitimit te pronesis nepermjet blerjes nga ana e te paditurit “K.” sh.p.k, nepermjet perfaqesueses se tij, te nje automjeti te markes CHRYSLER, lloji autoveture, tipi LLC JEPP PK JK5FH 81, me nr. Shasie XXXXXXXXXXXXXXXX, me xxxx, ngjyra xxx me targa **XX XXXX X**.
- d. Me shkresen nr. 2208/1 prot., date 06/04/2011 te Drejtorise se Pergjithshme te Sherbimeve te Transportit Rrugor, Tirane provohet fakti se shoqeria “Komunitete” sh.p.k ka te rregjistruar ne pronesi te saj automjetet me targa **XX XXXX X dhe XX XXXX X (kjo e fundit eshte perjashtuar nga objekti i konfiskimit)**.
- e. Me shkresen nr. 2181 prot., date 05/04/2011 te Raiffeisen Bank SH.A, Zona Berat, provohet fakti se i padituri “K.” sh.p.k eshte klient i kesaj banke dhe disponon llogarine rrjedhese me nr. 0100808845 e cila ka gjendje shumen prej **47,112.17** leke.

Lidhur me kerkesen e Prokurorise per Krime te Renda per konfiskimin e ketyre pasurive te te dy te paditurve si “K.” sh.p.k ashtu dhe te shtetasit M. Ç. , kjo gjykate konstaton se te gjitha pasurite qe kerkohen te konfiskohen jane te rregjistruar ne emer te te paditurit “K.” sh.p.k dhe jo te shtetasit M. Ç. .

Pra ky gjykim nuk duhej te ngrihej ndaj shtetasit M. Ç. pasi nuk i cenohen te drejta personale pasurore. Ne kete gjykim shtetasi M. Ç. duhet te vinte vetem si perfaqesuesi ligjor i shoqerise “K.” sh.p.k, duke qene se eshte ortaku i vetem dhe administrator i saj.

Mbi keto te dhena kjo gjykate ne kushtet e mungeses se vertetimit te prejardhjes se ligjshme te pasurive te sekustruara, te cilat nuk jane justifikuar si te tilla as nga i padituri “K.” sh.p.k ne aplikim te nenit **24/1** te ligjit nr. 10192, date 03/12/2009 “*Per Parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese Kunder Pasurise*” vendos konfiskimin e ketyre pasurive.

Me vendimet per sekustrimin e sendeve date **21/04/2011** dhe

**10/05/2011** te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Berat, provohet fakti se te gjitha automjetet objekt i ketij gjykimi jane sekuestruar edhe per llogari te procedimit penal nr. 82, date 28/02/2011 ne ngarkim te te pandehurve “K.” sh.p.k etj.

Meqenese kjo pasuri eshte sekuestruar ne kuader te procedimit penal nr. 82 te vitit 2011, i cili ne daten 25/11/2011 eshte derguar per gjykim ne Gjykatën e Rrethit Gjyqesor Berat kjo gjykate vlereson se ne baze te nenit 5 te ligjit nr.10192 date 03/12/2009 ***“Per parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese Kunder Pasurise”*** duhet te urdheroje edhe pezullimin e pasojave te zbatimit te mases se konfiskimit te dhene ne kuader te ketij ligji.

Ne baze te dispozites se ligjit te posaçem te cituar me siper *“...Pezullimi perfundon me dhenien e nje vendimi gjyqesor penal per revokimin ose shuarjen e ketyre masave”*.

Pra efektivisht, masa e konfiskimit e dhene nga kjo gjykate ne lidhje me 3 automjetet, do te zbatohet pas disponimit qe do te behet ne perfundim te procedimit penal nr 82 te vitit 2012 te Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Berat per veprat penale te “Mashtrimit” dhe “Pastrimit te produkteve te vepres penale”, parashikuar nga nenet 143/2 dhe 287 te Kodit Penal, procedim i cili zhvillohet ndaj te pandehurve “Komunitete” sh.p.k, M. Ç. etj.

Ne zbatim te nenit **29/1** te ligjit nr.10192 date 03/12/2009 llogaria bankare me nr.10192 date 03/12/2009 prane Raiffeisen Bank ne emer te te paditurit “K.” sh.p.k (**per te cilen nuk ka sekuestro per llogari te procedimit penal**) si pasuri e konfiskuar me vendimin e kesaj gjykate kalon ne favor te shtetit duke patur si institucion pergjegjes per administrimin e saj Agjencine per Administrimin e Pasurive te Sekuestruara dhe Konfiskuara mbi parashikimin e nenit 29/2 te ligjit nr.10192 date 03/12/2009.

Per Administrimin dhe perdorimin e **kesaj llogarie bankare** ngarkohet **z. K. Xh.** , i cili eshte administrator prane Agjencise per Administrimin e Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane.

Mbi arsyetimin e pasqyruar me siper ne baze te nenit 212 e vijues te Kodit te procedures civile dhe neneve 3,5, 21, 22 24, 25 e vijues te ligjit **nr. 10192, date 03/12/2009** ***“Per parandalimin dhe Goditjen e Krimet te Organizuar dhe Trafikimit Nepermjet Masave Parandaluese Kunder Pasurise”***, kjo gjykate pasi formoi bindjen dhe ne mbeshtetje te provave te shqyrtuara ne kete gjykim:

## **VENDOSI**

Pranimin e kerkeses se Prokurorise prane Gjykares se Shkalles se Pare per

Krime te Renda Tirane duke konfiskuar dhe kaluar ne pronesi te shtetit pasurite e te paditurit "K." sh.p.k si :

- Mjetin e markes Mit Subishi, lloji foristrade, tipi Mitsubishi Pajero, me nr. Shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX, me xxxx, ngjyra xxx me targa **XX XXXX X**
- Mjetin e markes Benz, lloji autoveture, tipi Benz 190, me nr. Shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX, me xxxx, ngjyra xxxx, me targa **XX XXXX X**.
- Mjetin e markes CHRYSLER, lloji autoveture, tipi LLC JEPP PK JK5FH 81, me nr. Shasie XXXXXXXXXXXXXXXXXXXX, me xxxx, ngjyra xxx me targa **XX XXXX X**.  
Llogarine bankare ne Raiffeisen Bank me nr. XXXXXXXXXXXX ne emer te Shoqerise "K." sh.p.k., ne shumen **47,112.17** leke.
- **Pezullimin e pasojave te zbatimit te mases se konfiskimit** te tre automjeteve te llojit Mit Subishi, foristrade, me targa **XX XXXX X**, Benz, autoveture, me targa **XX XXXX X** dhe CHRYSLER, autoveture me targa **XX XXXX X** derisa te perfundoje dhenia e nje vendimi gjyqesor penal per revokimin ose shuarjen e masave te sekuestros se dhene nga Prokuroria e Rrethit Gjyqesor Berat me date 21/04/2011 dhe 10/05/2011 per te njejtat pasuri.
- **Per ekzekutimin** e ketij vendimi ngarkohen Zyrat e Permbarimit te Rretheve **Tirane dhe Vlore, ndersa per Administrimin dhe perdorimin** e pasurive ngarkohet **Z. K. Xh.** , i cili eshte Administrator ne Agjencine per Administrimin e Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane.
- Urdhërohet sekretaria gjyqesore te njoftoje kopjen e ketij vendimi Agjencise se Administrimit te Pasurive te Sekuestruara dhe te Konfiskuara prane Ministrise se Financave Tirane, Zyrate te Permbarimit Gjyqesor Tirane dhe Vlore si dhe Prokurorise se Rrethit Gjyqesor Berat.
- Shpenzimet gjyqesore i ngarkohen te paditurit "K." sh.p.k.
- Kunder ketij vendimi lejohet ankim, brenda afatit ligjor, ne Gjykatën e Apelit per Krime te Renda Tirane.

U shpall sot ne Tirane me, **29/10/2012, ora 13.38**

**SEKRETAR**

Besjan HYSI

**GJYQTARE**

Iliriana OLLDAS





